

BULETIN INFORMATIV

Aktivitetet e muajit Dhjetor 2025

www.cp-project.al info@cp-project.al



Aktivitetet ndërgjegjësuës i MB për “16 ditët e Aktivizmit kundër Dhunës me Bazë Gjinore dhe Dhunës Dixhitale”


Me iniciativën e Ministrisë së Brendshme dhe me mbështetjen e Programit Suedez: ‘Forcimi i Policimit në Komunitet në Shqipëri’ (SCPA), një aktivitet i veçantë ndërgjegjësimi u organizua më 5 dhjetor 2025 në kuadër të 16 Ditëve të Aktivizmit kundër Dhunës me Bazë Gjinore.

Aktiviteti mbledhi së bashku përfaqësues nga agjencitë ligjzbatuese të Shqipërisë, si Ministria e Brendshme (Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit për Migracionin dhe Azilin), Policia e Shtetit Shqiptar (Departamenti për Sigurinë Publike dhe Drejtoria e Hetimit të Krimeve Kibernetike), Qendra e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (CVE), Bashkia e Tiranës dhe institucione të tjera publike, organizata të shoqërisë civile (organizata ‘Gruaja te Gruaja’ si përfituese granti në Programin SCPA), dhe organizata ndërkombëtare (UN Women, UNDP, UNCHR, OSBE, IOM dhe Delegacioni i BE-së në Shqipëri) të bashkuara në angazhimin e tyre për të parandaluar dhe eliminuar dhunën dixhitale ndaj të gjitha grave dhe vajzave.

Diskutimet kryesore u përqendruan në forcimin e bashkëpunimit

ndërinstitucional për të identifikuar, parandaluar dhe reaguuar ndaj dhunës online; Adresimin e abuzimit online, përndjekjes kibernetike dhe kërcënimeve të tjera dixhitale që kanë si shenjestër gratë dhe vajzat; Përmirësimin e mbrojtjes ligjore dhe përmirësimin e Kodit të ri Penal për të adresuar më mirë ngacmimin online, përndjekjen dhe dhunën psikologjike; Përgjegjësinë e kompanive të teknologjisë për të krijuar mjedise online më të sigurta.

Ministrja e Brendshme theksoi faktin se një betejë e tillë e përbashkët mund të fitohet nëpërmjet ndërgjegjësimit, edukimit, respektit dhe gjuhës që zgjedhim të përdorim në hapësirën dixhitale.




AKTIVITETET KRYESORE:

- ◆ Aktivitetet ndërgjegjësuës i MB në kuadër të fushatës ‘16 ditët e Aktivizmit kundër Dhunës me Bazë Gjinore dhe Dhunës Dixhitale’
- ◆ Trajnimi i Oficerëve të Patrullës së Përgjithshme dhe personelit të SKK për zbatimin e PK në DVP Vlorë
- ◆ Thirrja Nr.2 për Aplikime në kuadër të Skemës së Granteve të programit SCPA
- ◆ Fushata “16 Ditë të Aktivizmit kundër Dhunës me Bazë Gjinore” – Dhjetor 2025
- ◆ NSPK-të për edukimin vazhdojnë punën ndërgjegjësuëse në shkolla



Trajnimi i OPP dhe personelit të SKK për zbatimin e Policimit në Komunitet -DVP Vlorë



Në datat **03-05,dhe 10-12 Dhjetor 2025**, dy grupe të Oficerëve të Patrullës së Përgjithshme, si dhe personeli i Sallës së Komandës dhe Kontrollit të DVP Vlorë (grupi i tretë dhe i katërt, Komisariati i Policisë Vlorë dhe Himarë), morën pjesë në trajnimin e organizuar nga Ekipi i Menaxhimit të Programit SCPA.

Në total, **35 pjesëmarrës** u përfshinë në këtë trajnim.

Gjatë këtij trajnimi të trajnuarit u njohën si me pjesën teorike ashtu edhe me ushtrimet praktike dhe me punën në grup, duke u fokusuar në filozofinë e Policimit në Komunitet dhe zbatimin e elementeve të saj në punën

e përditshme të oficerëve të Policisë së Shtetit.

Gjithashtu, atyre iu prezantuan situata/ushtrime praktike për t'u trajtuar dhe zgjidhur prej tyre teksta punuan në grup me synimin për të siguruar masat që duhen marrë në mënyrë proaktive për zbatimin e elementeve të Policimit në Komunitet.

Vëmendje e veçantë iu kushtua trajtimit të rasteve të **Dhunës në Familje** si në aspektin teorik ashtu edhe atë praktik.

Me qëllim për të ofruar module trajnimi gjithëpërfshirëse, ekipi i Programit SCPA bashkëpunoi me

Qendrën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, ekspertët e së cilës ofruan leksione ndërvepruese mbi luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm.

Praktikat më të mira të BE-së për zbatimin e filozofisë së PK-së u ndanë dhe u shkëmbyen me oficerët e PSH.

Në përfundim të këtij trajnimi, oficerët e PSH arrijnë të përmirësojnë njohuritë dhe kapacitetet e tyre për zbatimin e Policimit në Komunitet.



Thirrja Nr.2 për Aplikime në kuadër të Skemës së Granteve të programit SCPA

Programi "**Forcimi i Policimit në Komunitet në Shqipëri – SCPA**", i financuar nga Qeveria Suedeze, gjatë muajit nëntor shpalli **Thirrjen Nr. 2 për Aplikime në kuadër të Skemës së Granteve**.

Ky program mbështet zbatimin e reformës së policimit në komunitet dhe fton Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC), konsorciume dhe organizata me bazë komunitare të dorëzojnë projekt-propozime.

Gjatë kësaj periudhe, programi SCPA po pranon aplikimet, të cilat më pas do të shqyrtohen nga

komisionet vendore përzgjedhëse. Projektet e përzgjedhura do të shpallen si fitues të granteve në fazën e ardhshme

Qarqet e zbatimit:
Qarqet: **Tiranë, Korçë, Kukës, Gjirokastrë**

Përfshihen jo vetëm bashkitë qendër qarku, por edhe bashkitë përbërëse ([p.sh.](#) Kamëz, Pogradec) dhe njësitë administrative të tyre.

Në shpallje janë cilësuar **Llojet e granteve** si me poshtë :
Deri në 20,000 € → projekte deri

në 18 muaj; Deri në 10,000 € → projekte deri në **12 muaj**.

Shpallja ka pasqyruar dhe detajet e mëposhtëm për tu pasur parasysh nga aplikuesit
Dokumentacioni & Afatet

- ⇒ Formulari i Aplikimit dhe Udhëzuesi: cp-project.al
- ⇒ Pyetje/sqarime: deri më **10 Dhjetor 2025** në grants@cp-project.al
- ⇒ Dorëzimi i aplikimeve: deri më **02 Janar 2026**, vetëm me email në grants@cp-project.al
- ⇒ Detaje të plota: www.cp-project.al

Fushata “16 Ditë të Aktivizmit kundër Dhunës me Bazë Gjinore” – Dhjetor 2025



Gjatë muajit dhjetor 2025, institucione shtetërore, organizata të shoqërisë civile dhe partnerë ndërkombëtarë zhvilluan një sërë aktivitetesh ndërgjegjësimi në kuadër të fushatës globale kundër dhunës me bazë gjinore.

Ja disa nga momentet kryesore:

- **Qendra Kombëtare për Shërbime Komunitare – Fier:** Më 10 dhjetor, nxënësit e shkollës “Halit Grëmi” morën pjesë në diskutime interaktive mbi format e dhunës dhe raportimin e saj. Fëmijët u fuqizuan me mesazhe frymëzuese si “Mos lejo askënd të të dhunojë” dhe “Ti nuk je vetëm”.
- **“Gruaja tek Gruaja” – Malësi e Madhe:** Në shkollat “Dodë Kaçaj” dhe “Sherif Hoxha” u zhvilluan takime me të rinjtë për policimin në komunitet, sjelljen në rrejetet sociale dhe sigurinë pranë shkollës.

Nxënësit analizuan situata reale dhe propozuan forma konkrete bashkëpunimi mes shkollës, familjes dhe policisë.

- **Forumi i Gruas Elbasan:** Forumi i Gruas Elbasan, gjatë muajit dhjetor vazhdoi me fushatën e 16 ditëve kundra dhunës me bazë gjinore me nxënësit e Gjimnazit “Vasil Kamami”, Elbasan, shkollën 9-vjeçare “Asllan Shahini”, Gramsh dhe Komisaritet e Policisë Elbasan dhe Gramsh si dhe me nxënësit e gjimnazit “Sinan Tomorri, Cerrik , në bashkëpunim me Komisaritetin e Policisë Cerrik . Aktivitetet u fokusuan tek dhuna digjitale dhe partneriteti mes policisë, aktorëve lokalë dhe komunitetit. Mesazhi kryesor: “Dhuna dixhitale vret njëlloj si dhuna fizike”.
- **Shoqata “Gender, Paqe e Siguri” – Durrës:** Në shkollën “Beqir Çela” u diskutua mbi shenjat e dhunës digjitale dhe mbrojtjen personale online, duke

theksuar se dhuna digjitale është dhunë e jetës reale.

- **Qendra Kombëtare për Shërbime Sociale – Tiranë:** Në Njësinë Administrative nr. 1, gratë dhe vajzat u informuan mbi të drejtat e tyre dhe mënyrat e raportimit të dhunës, duke forcuar solidaritetin dhe ndërgjegjësimin kolektiv.
- **Qendra “Epoka e Re” – Fier:** Më 16 dhjetor, në shkollën “Petro Sota” u organizua forum mbi parandalimin e kriminalitetit tek të rinjtë, duke trajtuar faktorët socialë, edukimin ligjor dhe mbështetjen psiko-sociale si elementë kyç për reduktimin e riskut.

Këto aktivitete tregojnë angazhimin e institucioneve dhe komuniteteve për të ndërtuar një shoqëri më të sigurt, të barabartë dhe të lirë nga dhuna – fizike apo digjitale.

NSPK-të për edukimin vazhdojnë punën ndërgjegjëse në shkolla



Në zbatim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve dhe Ministrisë së Brendshme, si dhe në përputhje me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 1076, datë 14.09.2022, “Për zbatimin e Programit ‘Siguria e të Rinjve’ në shkollat 9-vjeçare publike dhe jo publike,” Ndhmës Specialistët e Policimit në Komunitet për Edukimin dhe Punën me të Rinjtë kanë vijuar me përkushtim aktivitetet e tyre gjatë muajit **Dhjetor, 2025.**

Objektivi kryesor i këtij programi është ngritja e ndërgjegjësimit të të rinjve për çështje të sigurisë personale sidomos në rrjetet kibernetike, ndërgjegjësimi kundër përdorimit të duhanit, alkoolit dhe drogës.

Në kuadër të këtij programi, NSPK-të kanë bashkëpunuar ngushtësisht me koordinatorët vendorë të Zyrave Arsimore Vendore (ZAV), duke hartuar së bashku një kalendar të detajuar mujor për zhvillimin e temave në shkollat 9-vjeçare që ndodhen brenda

zonave të tyre policore. Gjatë muajit nëntor, fokusi i veçantë ka qenë te temat e ndërgjegjësimi kundër bullizmit dhe përdorimit të duhanit, alkoolit dhe drogës te cilat përbëjnë prioritetet në edukimin e fëmijëve për mbrojtjen e jetës dhe parandalimin e rreziqeve të mundshme në përditshmërinë e tyre.

Gjithashtu, janë trajtuar edhe tema të tjera që lidhen me edukimin qytetar, në bazë të kërkesave të komunitetit arsimor dhe situatave specifike të secilës zonë.

Përmes platformës online të monitorimit të aktiviteteve, është vërejtur një angazhim i shtuar nga ana e NSPK-ve që operojnë në komisaritet e qyteteve **Tiranë(7 Komisaritet përkatëse), Fier, Lushnje Durrës, Shkodër, Lezhe, Kurbin, Mirdite Korçë, Pogradec, Elbasan, Vlorë, Gjirokastrë, dhe Kukës.**

Këto njësi kanë treguar një intensitet të lartë pune, duke realizuar takime të shumta dhe duke shpërndarë

materiale ndërgjegjëse përmes rrjeteve sociale dhe forumeve online.

Në total, janë postuar **248** materiale dhe aktivitete që janë parë në mënyrë interaktive nga **3462** përdorues, duke dëshmuar një interes të madh nga publiku.

Për më tepër, janë regjistruar gjithsej **101** komente në këto postime, të cilat në pjesën më të madhe kanë qenë pozitive, përshëndetëse dhe vlerësuese për punën dhe përkushtimin e treguar nga specialistët e Policisë së Shtetit.

